Furnizimi i automjeteve dhe i bombolave me GLN do te behet me anen e pajisjeve bashkekohore, duke siguruar eliminim te plote te rrjedhjeve.

Depozitat e GLN-se do te furnizojne, nepermjet linjave teknologjike nentokesore, 2 distributore me 2 pistoleta aktive. Depozitat jane instaluar ne pjesen fundore te Impiantit, dhe jane te vendosur ne jasteke betoni ne lartesi mbi 1.5 metra nga siperfaqja e tokes. Lidhjet teknologjike jane te vendosura ne larteesi te pakten 1 meter nga siperfaqja e tokes.

#### **EFEKTET POZITIVE DHE NEGATIVE TE IMPIANTIT TE GLN-se NGA PIKPAMJA E NDIKIMEVE NE MJEDIS**

Ndertimi dhe funksionimi i Impiantit te Depozitimit te GLN-se dhe me tej per shitje me shumice per te trete (hotele, lokale, dyqane shitjesh, etj) do te kete ne menyre te natyrshme ndikimet e tij ne mjedisin e zones ne fjale, dmth. ne territorin qe kufizon Impiantin, por edhe ambientet publike kufitare deri ne nje distance te caktuar. Ne te njejten kohe do te kete ndikim ne banoret e komunitetit, ne zonen perkatese, etj.

Impianti i administruar nga Shoqeria "BESA GAZ" me DrejtorE te Pergjithshem Z. Islam Kazazi, me stafin punonjes do te kryeje aktivitetin kryesor:

- ◆ depozitimim me shumice te GLN-se,
- ◆ shitjen me shumice (me autocisterna) dhe me pakice (me bombola).

Ne menyre te vazhdueshme, nga pikpamja e kembimit te efekteve e vlerave me mjedisin rrethues, ky aktivitet do te konsiderohet nje proces i vijueshem pune i stafit te impiantit per ruajtjen dhe permiresimin e vlerave mjedisore ne territorin e impiantit e zonen perreth tij, per minimizimin e efekteve negative dhe shtimin e atyre pozitive.

### **EFEKTET POZITIVE**

- Territori ku eshte ndertuar objekti eshte marre me qera nga shoqeria "BESA GAZ". Aktualisht trualli eshte i perbere nga hapesire boshe, ne distance rreth 500 m larg rruges nacionale Kavaje-Rrogozhine. Me realizimin e ketij projekti subjekti e ka ndryshuar kete mjedis ne favor te nje Impianti per Depozitim dhe Mbushje te Bombolave me GLN bashkekohor e modern, c'ka perben nje permiresim te dukshem nga ana vizuale.
- Vendi i zgjedhur per ndertimin e Impiantit te GLN-se eshte mjaft i favorshem. Impianti i GLN-se se bashku me infrastrukturen e tij funksionale eshte i vendosur ne nje zone larg banesave dhe aktiviteteve te tjera ekonomike duke shmangur e minimizuar mundesine e ndodhjes se aksidenteve.
- Vendi i zgjedhur per ndertimin e Impiantit te GLN-se eshte i favorshem edhe per faktin se ploteson kushtet teknike e urbanistike. Rreth e rrotull tij, prapa, ne te majte e ne te djathte te objektit gjenden siperfaqe te lira dhe nuk zhvillohen aktivite apo te jete ne ndertim ndonje objekt tjeter. Objekti me te gjitha infrastrukturen polifunksionale te planifikuar, eshte i hedhur ne gen-plan (shih plan vendosjen).
- Nje epersi te dukshme ne ndertimin e Impiantit te GLN-se ne pozicionin ne fjale perben fakti, se ai gjendet ne distanca te pranueshme largesie karshi zonave te banimit, duke menjanuar keshtu ne nje mase te konsiderueshme ndotjet dhe zhurmat per komunitetin. Nga keto fakte kemi arsye te besojme se aktiviteti i Impiantit te GLN-se, i shoqeruar normalisht edhe me masa te tjera teknike preventive, nuk do te shkaktojte reagime e ankesa te cfaredo lloji nga ky komunitet.
- Nje Impiant i tille bashkekohor me infrastrukture funksionale do te zgjidhe me se miri punesimin e te pakten 10 punonjesve te rinj, punetore sherbimi ne mbushje dhe shperndarje, duke perfshire ketu specialiste hidrokarburesh, mekanike, ekonomiste etj, fakt qe perben nje efekt pozitiv nga pikpamja social-ekonomike.
- Ne pjeset kufitare te territorit te impiantit te GLN-se dhe ne veçanti ne pjeset anesore te tij, jane krijuar siperfaqe te mbjella me gjelberim me drure dekorative e lule natyrale. Efekti i tyre pozitiv natyrshem do te kompensoje efektet mjedisore te specifikes se aktivitetit, por dhe nga pamja vizuale, siperfaqet e gjelberuara dhe mikroterritoret shlodhese ne to, do te japin nje tablo urbane te kenaqeshme.

### **EFEKTET NEGATIVE**

Ne pergjithesi per shkak te specifikes se aktivitetit, Impianti qe kerkohet te vihet ne funksionim do te paraqese mundesine e lindjes dhe veprimt te efekteve negative me rezultat ndotjen mjedisore ne territor, por dhe ne ambientin perreth tij deri ne nje distance te caktuar.

**Ndotje te mjedisit mund te vijne nga:**

- *Rrjedhja e karburanteve apo lubrifikanteve gjate furnizimit te automjeteve.*
- *Shperndarja e gazrave ne hapsiren qe kufizon territorin, por dhe perreth tij, gjate manipulimeve te ndryshme qe kryhen ne Impiant.*

**Ndotjet mund te jene:**

- *ujrat dhe lengjet qe precipitojne nga zonat e furnizimit me GLN,*
- *ujrat larese qe precipitojne nga zonat e parkimit te automjeteve,*
- *ujrat larese qe kane origjine larjet e territorit te Impiantit te GLN-se, e ne vecanti pjeses se distributoreve, te zyres se sherbimit, WC-se, etj.*

**Ndikimi nga depozitimi ne ujrat nentokesore i materialeve dhe mbeturinave qe ndotin ujin mund te jene:**

- *vajrat minerale dhe kimikatet (aditivet) ne sherbim te tyre,*
- *mbetjet e vajrave te perdorur,*
- *detergjentet e ndryshme qe perdoren ne pune e siper,*
- *mikrombetje te ndryshme me origjine mekanike,*
- *mbeturina te ndryshme nga larjet, etj.*

**Ndikimi nga zhurmat me origjine te ndryshme mund ose do te jene:**

- *nga trafiku i mjeteve te furnizimit,*
- *nga moto-gjeneratori, etj.*

**Ndikimi ne ndotjen e ajrit mund ose do te jete:**

- *nga avullimi i karburanteve dhe vajrave,*
- *nga rritja e perqendrimit per shkak te pluhurave e tymrave te aktivitetit.*

**Ndikimi per raste aksidentale e rreziqe te tjera:**

- *zjarret mund te jene prezent,*
- *avari te ndryshme mund ose do te jene prezente, etj.*

### **Ndikimi ne rritjen e kerkesave per perballimin e problemeve te mesiperme nepermjet:**

- *Shtrimit e sistemimit te territorit.*
- *Sigurimit teknik dhe instruktimi per MNZ i punonjesve e specialisteve qe do te punojne ne Impianti e GLN-se, duhet te jete ne nivelet e kerkuare sipas rregullores perkatese ne fuqi.*
- *Furnizimi me energji elektrike te jete i vazhdueshem.*
- *Automjete furnizuese (autobotet) do te jene te siguruara ne fillim te shkarkimit e deri ne fund.*
- *Furnizimi me uje te pijshem dhe me ate qe do te perdoret gjate punes.*
- *Problemi i zgjidhjes se kanalizimeve dhe seperatorit te ujrave te ndotura aksidentalisht.*

### **MASAT E MARRA PER MINIMIZIMIN E PASOJAVE QE MUND TE KENE NE MJEDIS EFEKTET E MESIPERME NEGATIVE DHE RITJEN E ATYRE POZITIVE**

Bazuar ne qellimet kryesore e ne veçanti ate final, minimizimin ne maksimum te efekteve negative te lartpermendure dhe rritjen e atyre pozitive ne mjedis, stafi i Impiantit te GLN-se i administruar nga Z. Islam Kazazi, do te kryeje aktivitetin ne Impiant duke marre e vene ne zbatim masat konkrete si me poshte:

- ***Per ndotjen e mjedisit nga gazi i lenget qe mund te rrjedhe gjate furnizimit te depozitave me autobot ose gjate mbushjes se bombolave ne pistoletat e mbushjes***
  1. Kanali i grumbullimit te ujrave dhe karburanteve qe eventualisht mund te derdhen gjate manipulimit te tyre, do te perfundojne ne separatorin e ndarjes se hidrokarbureve nga uji.
  2. Çisterna e depozitimit te hidrokarbureve mbetje do te grumbulloje mbetjet e ndotjet gjate aktivitetit, dhe mbas nje cikli kohor do te mblidhen keto te fundit per t'u dorezuar per djegje apo riciklim sipas procedures se udhezuar nga ARM-ja Kavaje.
  3. Rezervuaret (depozitat metalike) do te jene me spesor mbi 6 mm, te tipit cilindrike horizontale, te lyer me boje anti korodive dhe dy duar shtrese bituminoze. Bokaportet, linjat e furnizimit te dyfishte si dhe tubat e ajrimin do te jene te montuar ne rezervuare konforme kerkesave tekniko teknologjike te eneve nen presion. Ato do te vendosen ne siperfaqe me mbeshtetese betoni. Mbas montimit te tyre dhe lidhjes se linjave te furnizimit me distributoret, ato do te provohen per ndonje carje te mundeshme me zbatimin e nje presioni hidraulik prej minimumi 0,75 kg/cm<sup>2</sup>.
  4. Furnizimi i rezervuareve me GLN do te behet me autobote, parametrat teknike e teknologjike te te cileve do te jene ne perputhje me kerkesat e eneve nen presion. Mbushja e autoboteve apo bombolave me GLN prej tyre do te behet nepermjet tubacioneve metalike qe sigurojne nje rrjedhje me presion konstant per ne impiantin e mbushjes, i pajisur me sistemin manometrik per te kontrolluar presionet e punes. Muftat bashkuese ne te dy ekstremet e tubacionit do te jene objekt i rendesishem kontrolli per riparim apo zevendesim te mundeshem ne rast demtimi.
  5. Furnizimi me GLN do te behet ne distributore universal nepermjet pistoletave. Distributoret do te jene te vendosur ne bazament betoni duke respektuar rigorozisht balancimin, distancat e lirshmerite ne manipulimet e ndryshme ne to e perreth tyre. Gjate sherbimit, kolaudimit apo ndonje riparimi te mundeshem te pjeseve te distributoreve (pompa, tuba fleksibel, pistolette, etj), do te merren masa qe pajisjet te jene jashte sistemit te funksionimit te impiantit.

- **Per ujrat e ndotura dhe me mbetje**

1. Ujrat e ndotura dhe me mbetje qe do te precipitohen ne zonat e furnizimit, do te grumbullohen e do te trajtohen me separator te standartizuar, duke ndare mbetjet hidrokarbure e derivatet e tyre vajore.
2. Ujrat e godinave, zyrave dhe sheshit te impiantit te GLN-se qe mund te precipitohen nga rreshjet apo larjet ne sheshin para tyre, do te kullojne ne kanalet anesore nga ku te grumbullohara, do te vazhdojne te shkarkohen ne pusetat anesore te impiantit, e me tej ne kanal in kryesor, qe kalon aty prane rruges nacionale.
3. Ujrat qe do te precipitohen nga mjedisi rrethues gjate rreshjeve, do te kullojne e grumbullohen ne kanalet anesore e me tej ne kanal in kryesor te zones.
4. Ujrat e zeza te WC-se, banjos etj. do te shkarkohen direkt ne rrjetin e kanalizimeve ne magjistralin kryesor te ujrave te zeza qe perfundon ne nje grope septike.

- **Per mbrojtjen e ujrave nentokesore**

1. Rezervuaret (kapacitetet depozitues) do te jene cilesisht te garantuara si dhe te provuara paraprakisht nen presion mbi ate te lejuarin. Po kete garanci do te kene sistemi i tubacioneve furnizues te pompave te distributoreve dhe tubat e ajrimit. Siperfaqet e tyre ne kontakt me token do te jene te perpunuara me boje e lende hidroizoluese. Rezervuaret do te mbeshteten ne jasteke betoni. Ne ndihme te zbulimit te shpejte te rasteve aksidentale te tille, do te sherbeje vendosja ne depozitat e nje sinjalizuesi automatik. Po keshtu edhe linjat teknologjike do te jene te pajisura me aparature paralajmeruese ne raste rrjedhjeje.
2. Ne ndihme te vazhdimet te aktivitetit per raste aksidenti eshte parashikuar vendosja e nje rezervuari rezerve.
3. Pistoletat e mbushjes me GLN do te jene bashkekohore dhe cilesisht te garantuara. Pjeset e tyre do t'ju nenshtrohen periodikisht kontrollit vizual e teknik, kryesisht per ndonje carje te mundeshme per te cilat do te kete sinjalizues automatik. Lidhjet teknologjike me rezervuaret do te garantohen nga sisteme tubash metalike te cilesise se larte. Teresia e bazamentit te betonit dhe vendosjes se distributoreve ne te do te jete konform parametrave rigorozisht te percaktuar. Paralelisht me distributoret do te ndertohet nje kanal i vogel per te garantuar grumbullimin e rrjedhjeve ne ndonje rast te mundeshem, e qe me tej do t'i drejtoje ato ne nje mini-depozite te posacme per te tilla raste.

- **Per asgjesimin e mbetjeve**

1. Mbetjet jo te rrezikshme do te veçohen nga komponentet e pasterta e do te grumbullohen per nje depozitim e riciklim te mundeshem.
2. Mbetjet e rrezikshme ne te cilat do te bejne pjese ato vajore, vajra rrjedhese, agjente te ndryshem kimike, bojra, detergjente, etj. do te depozitohen ne nje kolektor te caktuar per grumbullimin e ketyre lloj mbetjeve.

- **Per minimizimin dhe evitimin e zhurmave te mundeshme**

1. Vend-ndodhja e impiantit te GLN-se, eshte planifikuar te jete ne nje distance te mjaftueshme nga vendbanimet e sektoret sociale te komunitetit te zones, distance kjo qe minimizon efektin zhurme e nuk do te sjelle probleme e gjeneroje reaksion negativ te tyre.

- **Per eliminimin e ndotjeve te ajrit**
  1. Per ruajtjen e nje temperature konstante sidomos gjate stines se veres, si kusht i domosdoshem paraprak per minimizimin e ngritjes se temperatures ne depozitat e GLN-se, pjesa e siperme e depozitave mbitokesore deri ne bokaportin e furnizimit, do te jete e mbuluar me nje sistem dushi me uje qarkullues nga depozita e ujit te impiantit.
- **Per menjanimin e korrozionit dhe carjes se depozitave**
  1. Per menjanimin e gerryerjeve, carjeve nga korrodimi te depozitave, do te merren te gjitha masat paraprake dhe ato kontrolluese gjate funksionimit qe kemi permendur me siper.
- **Per zgjidhjen e problemit te mbetjeve te ngurta**
  1. Ne rast pune normale te impiantit te GLN-se nuk do te krijohen mbetje te ngurta. Vetem gjate pastrimit periodik te rezervuarit, proces ky qe kryhet normalisht nje here ne pese vjet, do te merren masa qe parashikojne nje rast te tille ose me vendosjen e nje vaske portative ose me ndertimin e nje vaske betoni 2m X 1m X 1m per grumbullimin e mbetjeve nga rezervuaret.
- **Per zgjidhjen e problemit te furnizimit me energji elektrike**
  1. Te gjitha pajisjet e mjetet si depozitat, linjat teknologjike, pompat, etj. ku ruhet, perpunohet e qarkullon GLN-ja, per te eliminuar rreziket e krijimit ne to te ngarkesave elektrostatische, do te jene te tokezuara.
  2. Per gjithë sistemin e linjave qarkulluese nuk do te kete saracineska nderprerese por bashkim me fllanxha, qe te jete e siguruar lidhja elektrike e vazhdueshme me ane te urave.
- **Per sigurimin e autobotit**
  1. Autoboti do te jete i pajisur me zinxhirin e sigurise (shkarkimit) ndaj ngarkesave elektrostatische dhe ne te njejten kohe, para fillimit te zbrazjes (rimbushjes), do te tokezohe nepermjet ures lidhese tek pika e tokezimit (nyja) (shih gen-planin e objektit, rrjeti elektrik 0,4 Kv dhe tokezimi).
- **Per eliminimin e rasteve aksidentale si zjarre, shkarkime atmosferike, elektrike, etj.**

Ndertimi i impiantit te GLN-se ka patur parasysh dhe ka realizuar kerkesat teknike te vena nga Sektori i MNZ-se si me poshte:

- o Te vendosen rezervuaret mbi jasteke betoni.
- o Sistemi i pompave te vendoset 30 m larg rezervuareve te GLN-se.
- o Te ndertohet argjinature me bazament mur beton.
- o Mbi cdo rezervuar te vendoset sistem i ftohjes me uje.
- o Te ndertohet sistemi i shkarkimeve atmosferike.
- o Te ndertohet sistemi i kanalizimeve per dekantim dhe avakuim.

Duke respektuar dhe realizuar detyrat e lena nga MNZ-ja, mund te permendim se:

1. Per menjanimin e rasteve aksidentale si zjarre, shkarkimet, etj. do te jene ne gadishmeri ne vendin e caktuar 5 fiksa universal me kapacitet 10 litra seicili (3 ne depozitat dhe 2 ne aparatit distributor), dhe nje fikse e levizeshme 35 literse me rrota. Pajisjet shuarese do te jene te kater shkalleve te shuarjes se zjarrit.

2. Ne impiantin e GLN-se eshte parashikuar te vendoset nje depozite uji me kapacitet 60 m<sup>3</sup> uje.
3. Ne pika te ndryshme te impiantit te GLN-se do te jene te vendosura tabela kundra zjarrit.
4. Do te jene te afishuara rregulloret per mbrojtjen nga zjarri dhe ato te sigurimit ne pune.
5. Do te jete ne gjendje gadishmerie nje shkarkues elektrik

Duke qene se projekti ne te gjitha elementet e tij eshte i realizuar nga specialiste te fushave perkatese e do te zbatohet konform orientimeve te tyre, mendohet te mos kete asnje premise per rast aksidental. Eshte pikerisht pergjegjesia e larte me te cilen do te zbatohet ky projekt kushti themelor i garancise se banoreve te zonave perreth impiantit per mos pasje rasti te tille.

- ***Per shtrimin dhe sistemimin e territorit***

1. I gjithe territori qe perfshin impiantin e GLN-se do te jete i shtruar e i sistemuar konform projektit ne parametra e standarte bashkekohore
2. Siperfaqe te gjelberuara do te jene ne pjese te ndryshme konform projektit dhe ne vecanti ne brezin qe do te kufizojte impiantin ne pjeset anesore.

- ***Per sigurimin teknik te punonjesve***

1. Ne dokumentacionin bashkelidhur projektit, do te jene paraqitur rregullat e sigurimit ne pune, instruktazhi i vecante per kushtet e punes me lende djegese dhe masat e mbrojtjes nga zjarri, etj.

## **PROGRAMI I MENAXHIMIT PER ZBATIMIN E PROJEKTIT DHE I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE PROJEKTIT**

### ***Programi i menaxhimit per zbatimin e projektit dhe funksionimin e tij***

Investitori ka pergatitur programet e menaxhimit, si gjate fazes ndertuese, ashtu dhe per fazen e funksionimit dhe zbatimin te projektit. Faza ndertimore ishte parashikuar te zgjaste rreth 1 vit, kjo e ndare ne dy faza me afate 6-mujore seicila. Per sa i perket programit te menaxhimit pas ndertimit te objektit, ky eshte pergatitur me konkretisht pas perfundimit te objektit dhe instalimit te teknologjise per depozitimin e GLN-se dhe mbushjes se autoboteve dhe bombolave per perdorim nga klientet.

### ***10.2 Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis te projektit***

Monitorimi eshte nje proces i zbulimit te ndryshimeve ne se ato ndodhin, si dhe i percaktimit te drejtimit dhe matjes se shtrirjes se tyre. Objektivi themelor i ketij kapitulli eshte qe te ofroje rekomandime te pershtateshme, qe duhen zbatuar nga operatori, per te siguruar se aktiviteti qe do te zhvillohet do te garantoje mbrojtjen e zones, mbrojtjen e shendetit te punonjesve dhe te komunitetit, mbrojtjen e cilesise se ajrit dhe ujrave qe shkarkohen, minimizimin e mbetjeve teknologjike, etj.

Investitori i ka mundesite financiare dhe stafin drejtues inxhiniero-teknik per te pergatitur planin e monitorimit te ndikimit ne mjedis nga aktiviteti qe do te kryeje, si gjate fazes se ndertimit, ashtu dhe gjate fazes se venies ne funksionim te implantit te depozitimit dhe mbushjes se bombolave me GLN.

Te dhenat e monitorimit do te dergohen cdo 6-muaj prane Drejtorise Rajonale te Mjedisit, Kavaje.

### ***Te pergjithshme***

Objekti ndodhet ne dalje te qytetit te Kavajes, pergjate rruges nacionale Kavaje-Rrogozhine, ne krahun e djathte dhe rreth 500 m larg saj, ne nje parcele ne afersi te fshatit Ballutaj, Komuna Synej, territor ky nen juridiksionin e Rrethit Kavaje.

Duke patur parasysh rrezikshmerine e larte qe paraqet ky implant ne rast te ndonje zjarri aksidental, objekti eshte projektuar dhe ndertuar larg zones se banuar dhe afer rruges automobilistike, per te lehtesuar mundesine e nderhyrjes se shpejte ne rast se paraqitet nevoja.

**Fillimi i ketij aktiviteti, me synim venien ne funksionim te nje impianti depozitimi te GLN-se, ka si objektiv:**

- **Depozitimimin e gazit te lengezuar te naftes (GLN), i importuar me autocisterna, ne kater depozita me kapacitet 100 m<sup>3</sup> seicila;**
- **shitje me shumice (furnizim me autobote pika te karburanteve, hotele, restorante, institucione, etj);**
- **dhe shitjes me pakice (furnizim te konsumatoreve te vegjel me bombola te madhesive te ndryshme).**

**Kryerja e ketij aktiviteti ne kushte normale kerkon qe ai te jete i koordinuar dhe ne perputhje dhe me shume aktivitete te tjera jetesore dhe ekonomike te zones. Vemendje e vecante duhet te kihet sidomos:**

- ✓ kur keto aktivitete jane afer qendrave te banuara,
- ✓ kur nga keto aktivitete mund te ndikohet popullata e fshatrave perreth,
- ✓ per popullsinen dhe aktivitetet ekonomike te zones perreth,
- ✓ kur ka objekte industriale qe kane ndikim ne cilesine e mjedisit te rajonit perreth,
- ✓ kur jane zona qe kane nje status te vecante, etj.

Pra mund te themi se nga ky aktivitet nuk pritet te kete ndikim mjedisor te matshem pasi:

- Nuk ka prodhim te mbetjeve te rrezikshme
- Nuk shkakton ndotje te tokes me shkarkime te ndryshme te lengeta, apo te ngurta
- Nuk ka shkarkime ne ajer te gazrave apo tymrave
- Zhurmat ne mjediset e punes do te jene brenda normes sanitare te lejuar, dhe per pasoje as zhurmat ne mjediset e jashtme nuk pritet te kene ndikim ne popullaten perreth
- Nuk ka clirim te aromave te ndryshme, etj



- Ka vlera normale te temperatures dhe te lageshtise ne mjediset e punes
- Jane parashikuar marrja e te gjitha masave per mbrojtjen ne pune dhe masat per evitimin e rrezikut te zjarrit

**Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis** eshte pergatitur si pjese e dokumentacionit qe duhet per te marre miratimet e zhvillimit te aktivitetit nga institucionet perkatese.

Raporti eshte pergatitur sipas kerkesave qe shtron Ligji "**Per Mbrojtjen e Mjedisit**". Ai synon te jape aspektet mjedisore te aktivitetit dhe ndikimet e mundshme ne mjedis si rezultat i zhvillimit te tij.

Ne Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis shoqeria "BESA GAZ" Shpk jep informacionin e duhur:

- per zonen e vendndodhjes se impiantit te GLN-se, qe i perket Rrethit Kavaje,
- per aktivitetin qe eshte menduar te kryhet ne perputhje me kerkesat mjedisore,
- per zhvillimin e aktivitetit te depozitimit dhe mbushjes se bombolaveme GLN qe do te jete ne perputhje me kriteret per mbrojtjen e mjedisit.

### ***Monitorimi i ndikimeve ne mjedis i aktivitetit***

Proçesi i monitorimit do te perqendrohet dhe fokusohet:

- ✓ ne aktivitetin e ketij impianti GLN,
- ✓ ne faktoret qe gjenerojne ndikime negative ne mjedis,
- ✓ ne efektet e ketyre ndikimeve, dhe
- ✓ ne zbatimin e masave per zbutjen e tyre.

Monitorimet do te kryhen nga vete investitori, dhe ne rast te pamundesise teknike per realizimin e tyre do te kerkohet bashkepunimi i subjekteve te specializuara per fushat perkatese. Verifikimet, monitorimet apo auditimet do te organizohen nga institucionet administrative si DRM-ja dhe Ministria e Mjedisit,

### ***Plani i monitorimit***

Potencialet negative te permendura me siper mund te minimizohen duke marre nje sere masash te cilat cojne ne permiresimin dhe reduktimin e ndikimit ne mjedis.

### ***Efektet potencialet ndotese te mjedisit dhe masat mbrojtese gjate fazes se ndertimit dhe gjate fazes se operimit***

#### Pastrimi dhe pergatitja e sheshit

Sheshi ne te cilen eshte ndertuar objekti qe do te sherbeje per impliant depozitimi te GLN-se ka shume pak, ose aspak vegjetacion. Asnje dru qe eshte jashte zones se ndertimit te objekteve nuk eshte pritset.

Te gjitha paisjet qe do te kerkohen te perdoren dhe sjellin zhurma me te medha duhet te kufizohen ne oret e funksionimit, sipas situates perreth. Ne ditet qe ato do te perdoren do te synohet te kete nje numer minimal te punonjesve ne impliantin e GLN-se.

#### Konflikt me perdorimin aktual te tokes si toke bujqesore

Nuk do te jete nevoja per truall shtese, meqenese punimet do te jene teresisht brenda territorit ekzistues te impliantit.

#### *Shqetesime te ndryshme qe mund t'i shkaktohen komuniteteve lokale*

Te gjitha lejet duhet te merren nga autoritetet e komunitetit, dhe ne se perkohesisht preken sipërfaqe toke, ato pas perfundimit te punimeve duhet te kthehen ne gjendjen fillestare.

#### Vendosja e objekteve te impliantit

Nderhyrjet ne toke, gjate hapjes se themeleve dhe per shtrimin e linjave te dergimit te gazeve ne depozita, pritset te sjellin shqetesime te ndryshme. Punimet qe do te kryhen do te jene minimale per te zvogluar demtimin e sipërfaqes se tokes dhe te sasise se dherave te germuara.

#### Magazিনি dhe trajtimi i materialeve te rrezikshme

Duhet treguar kujdes per te evituar ndotjen e tokes dhe ujit nga pikimet dhe rrjedhjet e mundeshme te lubrifikanteve dhe solventeve qe do te perdoren gjate ndertimit te impliantit. Nje plan emergjence duhet te pregatitet ne rast te rrjedhjeve te lubrifikanteve dhe solventeve.

#### Hedhja e mbeturinave te ngurta dhe te lengeta

Problemet shqetesuese qe lidhen me ndotjen e mjedisit jane dhe mbetjet e ngurta qe do te gjenerohen gjate ndertimit te impliantit. Keto mbetje do te duhet te hidhen ne vende te caktuara nga pushteti lokal.

#### *Problemet shqetesuese ne lidhje me kontaminimin e ujit*

**Nuk do te lejohet hedhja e drejte per drejte e mbetjeve te ngurta apo te lengeta ne mjedis te hapur dhe ne vijat ujore.**

### ***Programi i monitorimit***

Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar, qe te gjitha ndikimet e mundeshme qe do t'i vijne mjedisit nga ndertimi dhe operimi i impiantit te depozitimit te GLN-se jane marre parasysh. Programi i monitorimit per seicilen ndotje potenciale qe mund t'i shkaktohet mjedisit eshte dhene me poshte dhe duhet te mbikqyret nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit.

Aspektet kryesore qe do te jene ne vemendje te monitorimit:

- ✓ Pastrimi dhe pergatitja e sheshit te ndertimit: duhet te evitohet prerja e drureve gjate pergatitjes se sheshit te ndertimit.
- ✓ Minimizimi i erozionit: duhet te jete nje detyre primare gjate pergatitjes se sheshit te ndertimit, shesheve ndihmese, etj.
- ✓ Monitorimi i te gjitha dokumentacionit te projektit te miratuar, etj. eshte objekt i kontrollit te vazhdueshem i shoqerise zbatuese.
- ✓ Hedhja e materialeve te nxjerre nga pergatitja e sheshit te ndertimit: kerkohet mbajtja e shenimeve perkatese ne regjistrin e punimeve te kryera. Te behet dokumentimi i materialeve te ngurta te parrezikshme qe hidhen ne vendet e paracaktuara.
- ✓ Dergimi i materialeve dhe i pajisjeve ne shesh: per kete aspekt eshte i nevojshem inspektimi i perhershem, i cili duhet te realizohet ne lidhje me kontrollin e emetimeve te pluhurit ne atmosfere gjate transportit te dherave.

### ***Plani i monitorimit te zhurmave gjate operimit***

1. Operimi i paisjeve dhe i makinerive: gjate procesit te ndertimit dhe funksionimit te impiantit duhet te monitorohet niveli i zhurmave, i cili nuk duhet te kaloje nivelet e caktuara.

## **PERPUTHJA E PROJEKTIT ME PLANET E RREGULLIMIT TE TERRITORIT DHE ME PLANET E ZHVILLIMIT EKONOMIK TE ZONES KU ZBATOHET PROJEKTI**

Bazuar ne Vertetimin e leshuar nga Komuna Synej qe e ka miratuar kete zone si zone per aktivitete ekonomike, dhe ne te njejten kohe me Planin Urbanistik Zonal te miratuar, eshte me rendesi te permendet se ky projekt perputhet me planet e zhvillimit ekonomik dhe me planet e rregullimit te territorit te zones ku eshte zbatuar projekti. Kjo eshte arsyeja qe investitorit i eshte miratuar leja e zhvillimit te aktivitetit ne kete objekt. (shih dokumentacionin bashkangjitur).

## PERMBLEDHJA E KESHILLIMEVE ME ORGANET E QEVERISJES VENDORE, PUBLIKUN, ETJ.

Bazuar ne kontaktet e marra me organet e qeverisjes vendore dhe shoqatat mjedisore, dhe ne dokumentacionin qe disponohet, duhet pohuar se shoqeria i ka kryer keshillimet dhe konsultimet e nevojshme me komunitetin e kesaj zone, dhe ne vecanti me drejtuesit e pushtetit vendor te komunes Synej. Kjo gje shprehet dhe ne mendimin e dhene, per lejimin e kryerjes se aktivitetit te shoqerise ne vendin ku eshte ndertuar objekti, nga ana e Komunes Synej.

## MASAT REHABILITUESE, NE RAST NDOTJEJE DHE DENTIMI TE MJEDISIT

Masat per mbrojtjen e mjedisit, qe jane marre nga ana e shoqerise jane:

- rregullimi, sistemimi dhe rrethimi i territorit,
- instalimi i sistemit te seperimit te ujrave te grumbulluara nga kanalet siperfaqesore te objektit,
- jane bere kanalizimet e brendshme te objektit te lidhura me tubacionin kryesor qe shkarkohet ne kanalin prane objektit,
- sistemet e parandalimit te aksidenteve ne impiant:
  - sinjalizuesit e rrjedhjeve te mundeshme te GLN-se
  - sistemi i ftohjes se depozitave ne stinen e nxehte
  - sistemi ifikes se zjarrit aksidenta, etj.

## PROBLEMET SOCIALE

**Punesimi.** Sektori i shitjes se karburanteve dhe nenprodukteve te saj me shumice dhe pakice zen nje vend te vogel ne perqindjen e aktiviteteve te biznesit, ku pjesen me te madhe e zene sherbimet. Por megjithate duke marre parasysh kerkesen ne rritje per to, keto aktivitete jane per t'u marre ne konsiderate dhe ne numrin e te punesuarve. Per kete zone krijimi i 10 vendeve te reja pune paraqet nje mundesi per angazhim te banoreve te zones perreth.

Gjate periudhes qe impianti i GLN-se do te vihet ne funksionim nuk ka per te rezultuar asnje problem social, si dhe nuk do te perbeje asnje shqetesim per banoret e zones perreth. Ndonese ka nje numer te kufizuar punonjesish, eshte patur parasysh nga ana e administratorit te shoqerise qe te punesohen banore te kesaj zone.

Sic eshte parashtruar edhe ne Gen-Planin qe ndodhet se bashku me dokumentacionin e shoqerise objektet e banimit jane ne largesi me objektin ku zhvillohet aktiviteti.

**Bujqesia.** Ne nje kendveshtrim tjeter, Kavaja eshte nje rajon qe vite me pare eshte njohur si bujqesor, ndersa pas ndryshimeve te viteve te fundit, bujqesia nuk perben me bazen me te rendesishme ekonomike. Kjo vjen per shkak te shndrrimit te karakterit te zones ne teresi nga bujqesor ne urban. Nder aresyet e renies se sektorit bujqesor eshte dhe fakti qe njerezit nuk shfaqin interes per t'u marre me bujqesi, dhe ata po punesohen gjithnje e me teper ne sektore te tjere te tille, si industria dhe sherbimet.

## SIPERFAQJA PYJORE

Zona e zgjedhur per ndertimin e impiantit te GLN-se eshte miratuar aktualisht si zone per aktivitete ekonomike jo ndotese. Pra eshte shesh i lire per ndertime objektesh ekonomike.

## FLORA, FAUNA, EKOSISTEMET

Vlerat faunistike ekzistuese dhe potenciale te zones nuk jane shume te pasura. Flora perbehet nga shume elemente te flores mesdhetare.

## TE DHENAT MBI KLIMEN

Klima e zones se Kavajes eshte klime tipike mesdhetare, qe karakterizohet me dimer te bute, ne raste te rralla me ngrica apo me rreshje debore.

Stina e veres karakterizohet me periudha te gjata te nxehti dhe thatesire, ndersa stina e vjeshtes sidomos muajt Nentor-Dhjetor ka sasine me te madhe te rreshjeve te shiut.

**Temperaturat.** Muajt Janar dhe Shkurt jane pergjithesisht muajt me te ftohte te vitit, gjate te cileve temperaturat minimale zbresin edhe nen zero grade, por temperatura mesatare e ketyre muajve luhetet midis 10-14 grade Celsius.

Muajt me te nxehte te vitit jane muaji Korrik dhe Gusht me nje temperature mesatare prej 22-26<sup>0</sup>C. Ne periudha te vecanta gjate ketyre 2 muajve temperaturat arrijne edhe 33-38 grade Celsius.

**Ererat.** Nga studimet shumevjecare te kryera rezulton se ne kete zone drejtimi i ererave eshte lindje-perendim dhe anasjelltas. Ererat qe fryjne ne kete zone, sidomos gjate stines se veres favorizohen edhe nga prania e detit qe ndodhet prane zones se qytetit Kavaje. Shpejtesia mesatare e eres eshte afersisht ne vlerat 1,6-1,8 m/sek.

**Reshjet.** Sasia mesatare vjetore e rreshjeve arrin 1.100-1400 mm. Muajt me me shume rreshje jane muajt Nentor, Dhjetor dhe Janar, ndersa sasia me e vogel e rreshjeve bie gjate muajve Korrik, Gusht, Shtator.

Zona e Kavajes karakterizohet pergjithesisht me vleren mesatare vjetore te rreshjeve te shiut te vendit.

**Diellzimi.** Ne zonen e Kavajes dhe perreth ditet me diell zene afersisht 280 dite/vit.

## **HIDROGJEOLGJIA E VENDBURIMIT**

Vendi qe propozohet nuk ka probleme hidrogjeologjike. Nga studimet hidrogjeologjike vihet re se ne vendin ku eshte ndertuar ipianti i GLN-se nuk ka rezerva uji nentokesor.

## **P E R F U N D I M E:**

Duke pare projektin ne kompleksitetin e vet si nje Impiant Depozitimi dhe Mbushje te Bombolave me GLN per shitje me shumice dhe pakice te saj, mendojme se duke zbatuar me rigorozitet parametrat bashkekohore te zhvillimit te ketij lloji aktiviteti, duke e manaxhuar me kujdes e ne menyre te vazhdueshme ate, por dhe masat e siperpermendura per ruajtjen e permiresimin e mjedisit, pasojat negative qe shoqerojne natyrshem kete aktivitet do te jene te kontrolluara.

**Pergatiti VNM- ne:**

**Inxh.Mj.Raimina Hakrama**

**Ekspert i VNM-se dhe Auditimit Mjedisor**

**g) Plan I perballimit te emergjencave**

**PER IMPIANTIN E DEPOZITIMIT , AMBALLAZHIMIT DHE  
TREGTIMIT TE GAZIT TË LËNGËZUAR TË NAFTËS**

## **HYRJE**

Plan i Emergjences per Shoqerine "BESA GAZ" shpk trajton ne vecanti, problemet e emergjences ne te cilat mund te ndeshemi ne incidentet me Gazin e Lengshem te Naftes (GLN). Keto incidente mund te kene shkaktare gabimet njerezore, incidentet gjate transportimit, procese te crregullimeve teknike, aktet terroriste, zjarri ose shperthime.

Plani i Reagimit te Emergjencave eshte nje pjese e rendesishme per nje menaxhim te materialeve te rrezikshme. Plani emergjences eshte i nevojshem per t'iu paraprire incidenteve qe mund te ndodhin per shkaqe te ndryshme, te cilat mund te sjellin deme si ne jetet e njerezve edhe ne demtimin e prones. Plani eshte i ndryshueshem ne vazhdimesi te procesit te punes dhe i sigurt. Personat pergjegjes duhet tu paraprijne ketyre ngjarjeve.

Plani i emergjences permban nje liste numrash telefoni per raste emergjente, nje plan te detajuar ne te cilat te perfshije perdorimin e nje kompleks informacionesh dhe implementimin e pajisjeve dhe procedurave te specializuara. Ne cfaredo rrethane, nje plan emergjence eshte patjeter i domosdoshem. Prioriteti jone kryesor eshte siguria ndaj komunitetit, ambientit dhe prones.

Plani eshte nje skice e pergjithshme, e pergatitur si minimale e standarteve te sigurise qe do te ndiqen nga shoqeria "BESA GAZ" shpk e menaxhimnit te GLN, ne menyre qe te siguroje nje biznes normal; sigurine ne pune te punonjesve te saj si dhe per te kryer operacionet ekonomike dhe ato te mbrojtjes nga zjarri ne menyre te sigurt, dhe arrijten e shmangies se punonjesve nga ndikimi negativ i avujve te GLN dhe pasojave te tjera qe gjenerojne nga shkaku GLN.

## **Sherbimi i Emergjencave**

Forcat e sigurise: 3 punonjes & 1 drejtues

M.K.Z.: 1 inspektor

Departamenti teknologjik: 5 punonjes

Departamenti i sigurimit teknik: 1 punonjes ( 1 inxhinier mekanik)

Departamenti ekonomik: 3 punonjes

Sherbimi i Zjarrfikses do te jete nje skuader vullnetare e formuar nga punonjesit e turnit,te departamentit teknologjik dhe te forcave te sigurise.

Forcat e Ligjit:

- Stafi i punonjesve te shoqerise eshte i kufizuar, por struktura per MNZSH jane ndertuar si nje detyre suplementare, e cila do funksionoje direk, pa asnje hezitim ,duke e nderprere punen (detyren) funksionale dhe duke mare detyren e re per te cilen edhe eshte trainuar.
- Sherbimet Emergjente Mjekesore Shoqeria "BESA Gaz" Shpk si dhe nuk ka ne organike nje strukture mjeksore. Sherbimin e kualifikuar per dhenien e ndihmes se pare e planifikuar te behet



nga nje staf i trainuar per te cilet eshte formatuar edhe nje cante e ndihmes se pare. Kjo cante permban medikamente specifike per eliminimin e efekteve te GLN ( AVUJVE) dhe per fashimin e ndonje frakture te mundeshme. Kjo strukture do veproje menjehere mbas nxjerrjes nga zona e mergjences te demtuareve dhe qe do kene nevoje per fashim.

- Komiteti i Planifikimit te Emergjencave lokale. Ne Shoqerine "BESA Gaz" Shpk. eshte ngritur Shtabi i Emergjences, i cili eshte duke drejtuar qe tani ne kohe normale punen per pergatitjen e infrastruktures per nje reagim normal ne nje te ardhme. Keshtu jane mare masa dhe jane vendosur tabelat udhezuese dhe orientuese per zbatimin e masave parandaluese te nje emergjence. Jane hartuar rregulloret e veprimeve operacionale ne shoqeri, rregullorja e Sigurise gjate punes me GLN, rregulloret, plani i emergjences per skenare te ndryshme ne zona te ndryshme te linjes teknologjike. Eshte bere nje program trainimi, i cili eshte duke u zhvilluar me te gjitha strukturat dhe qe do vazhdoje per cdo muaj, sipas nje plani te miratuar.

- Kompanite me te interesuara per kete plan emergjence jane kryesisht, Shoqeria "BESA Gaz" shpk e cila eshte dhe qendra e impaktit negativ qe ajo mund te jap dhe po kaq te interesuara jane edhe kompanite e tjera qe ushtrojne aktivitetin ne afersi te ketij impinati dhe ne kufijte ndares me te me aktivitetin e kesaj shoqerie.

## **GATISHMERIA PER EMERGJENCE GLN**

### **Njohurite**

### **Trajnim**

### **Planifikim**

### **Pike synimi**

Ne kete plan parshikohet trajnimi i personelit me dhenie informacionesh mbi gazin, per parandalimin, kontrollin dhe kufizimin e aksidenteve duke perfshire Gazin e Lengshem te Naftes (GLN).

Per trainimin e personelit eshte hartuar nje program ku jane perfshire tema te rekomanduara dhe nga IQT, sidomos ne drejtim te njohjes me vetite fiziko-kimike te GLN, te sjelljes se tij ne natyre, te shkaqeve te lindjes se nje zjarri, te mjeteve e metodave te luftes k/zjarr, etj tema te njohjes me linjen teknologjike, linjes se elektrikut, instalimeve te paisjeve e mjeteve zjarr/fikese dhe te tjera veprime.

Per kete program jane pergatitur specialistet e Shoqerise dhe temat e tjera do zhvillohen nga specialiste te PMNZSH-se te Prefekturs se Qarkut Tirane. Ne fund te ketij programi do zhvillohet nje ushtrim taktik me veprime te vete skuadres vullnetare te Shoqerise dhe nje variant ku do jete edhe nderhyrja e njesise te specializuar te PMNZSH-se.

## **Ripaisje per leje mjedisore**

**Objekti: "Impiant depozitimi dhe mbushje bombulash me GLN"**

---

Rendesi i eshte kushtuar njohjes se linjes teknologjike te GLN, vendet e pozicionet ku mund te lind nje incident si dhe veprimeve per izolimin e tij, etj pune.

Nje mase tjeter efikase eshte dhe masat qe jane mare per parandalimin e incidentit.

Per kete, specialistst e Shoqerise, kane hartuar nje Rregullore "Mbi te drejttat, detyrat, pergjegjesia e personelit te shfrytezimit te objekteve te ngarkimit te autocisternave me GLN".

Ne kete rregullore pershkruhet cfare duhet te zbatoje Teknologu, cfare Pompisti i Objektivit si dhe Rregulloren e Sigurimit Teknik dhe mbrojtjen ne pune. Ne keto rregullore jane cituar, ne detaje, te gjitha veprimet gjate punes me GLN ne cdo objekt.

Nje mase efikase eshte mare ne drejtim te perqendrimit te origjines se rrjedhjeve (si ne fl1anxha, valvula, ne rimbushje, etj) ne zona te ndryshme te linjes. Ne permiresimin e ventilimit per te ulur mundesine e rrjedhjeve te GLN, dhe menjanimi i gazrave.

Gjithashtu jane mare masa, treguar me tabela spjeguese, per te mos lejuar hyrjen e cdo njeriu ne, pa u autorizuar, ne Zonat e Kufizuara. Jane mare masa per te mos lejuar hyrjen e cdo lloi automjeti ne keto zona, Jane mare masa paraprake per ndalimin e pirjes se duhanit neper teritor si dhe perdorimin e zjarrit.

Keto dhe te tjera masa profilaktike, pjese e punes dhe pergjegjesise se teknologeve e specialisteve te mirembajtjes, jane masa efikase te parandalimit te incidenteve te mundeshme, referuar (shtojca 1).

## **Qellimi**

Plan i Emergjences per Gazin e Lengshem te Naftes eshte paracaktuar te parashikojte asistencen per nje reagim te shpejte dhe efektiv ne raste emergjencash.

## **Objektiva te Pergjithshme**

Parashikim i nje Grupi te Sherbimeve te Emergjences sipas:

Ne Shoqerine "BESA Gaz" Shpk., nga personeli punonjes i saj, eshte ngritur (organizuar) nje skuader vullnetare per perballimin e nje emergjence te mundeshme.

Kjo skuader do kete ne perberje te saj punonjes te turnit, si teknolog, manovrator, elektrikist punonjes, etj. Per trainimin e saj eshte hartuar nje program i detajuar qe permban tema per njohjen e linjes teknologjike, te avarive me apo pa zjarr, te mjeteve e paisjeve te luftes k/zjarr, te nje taktike lufte k/zjarr dhe kur ato do mbeshteyen nge PMNZSH-ja e Prefektures.

Nje informacioni te plote mbi Gazin e Lengshem te Naftes (GLN), SI nje lende e rrezikshme; (ref. Rregullores se Instruktit per Punonjesit e Shoqerise "BESA Gaz" shpk.)

- Ne kete objekt lejohen te punojne punonjes qe te dine mire rregulloret e inspektoriatit per pajisjet nen presion dhe bomblat e fucite te jene marre ne provim per aftesite e tyre teorike e praktike nga komisioni dhe te jene pajisur me deshmi.
- Ne kete objekt lejohen dhe punonjes qe te jene marre ne provim per rregulloret e sigurimit teknik, mbrojtjen ne pune, dhe te jene pajisur me leje perkatese.
- Ne kete objekt lejohet te punoje punonjes qe kane mbushur moshen 18 vjec dhe te jene te afte fizikisht.
- Per kete objekt punonjesit duhet te zbatoj rregulloret e inspektoriatit shteterorper pajisjet ne presion dhe te gjithë udhezimet e rregullores e te tjera te komisionit te nxjerra per pajisjet ne presion.
- Te gjithë punonjesit e objektit vine ne pune 15 minuta para, vishen me rrobat e punes, dorashka, mushama kundra gaz pasi bej ne kontrollin paraprak te cdo vendi pune, me pas fillojne pune.
- Nuk lejohet fillimi i punes ne keto objekte pa kartat e sigurimit teknik, pa kundragaz i cili gjate gjithë 8 oreshit mbahet krahe qafe ne gadishmeri.
- Ndalohen goditjet metalike, celsat dhe mjetet e tjera, me material qe shkakton shkendija ose te lyera me graso.
- Ngarkimi te behet me peshore dhe me pompe, ne peshe jo me te madhe se lejohet
- Territori mbahet paster, pa mbeturina, pa vajra e pa ndotje te tjera.
- Zjarrfikesja duhet te jete ne gadishmeri te plote dhe nuk perdoret per asnje qellim tjeter.
- Shkarkimi i tubogomave per makinat behet me ventilat perkates me k/gaz.
- Largimi i makine s prej pikes se ngarkimit behet 30 min pasi eshte stakuar tu bogoma nga makina.
- Ndalohet qendrimi i cdo punojesi tjeter ne territorin e ngarkimit. Makina e cisternave qendrimi i makinave apo ndezja e tyre kur behet mbushja e bomblave.
- Mbushja e rregjistrir te makinave, cisternave behet konform pikave qe percakton rregulloren e inspektoriatit per kete problem
- Ndalohet shkarkimi i gazit se lengezuar ne atmosfere, makinave apo cisternave.

- g) Permbledhje joteknike te raportit te VNM-se.  
Objekti: Impiant depozitimi dhe mbushje bombolash me GLN



**Adresa: Fshatin Ballutaj, Komuna Synej, Kavaje**

**Per Llogari te Shoqerise "BESA GAZ" sh.p.k**

**Pergatiti VNM – ne:**

**Inxh.Mj.Raimina Hakrama**

**NR.NIPT: L41609013T**

**TIRANE ME DATE 16.06.2014**

## HYRJE

Ne baze te procedurave te nevojshme per ndertimin dhe venien ne shfrytezim te ketij implanti depozitimi te GLN-se dhe mbushjes se bombolave per shitje me shumice, keto te diktuar nga:

- ✓ *Ligji Nr. 8450, date 24.02.1999 "Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit, dhe te nenprodukteve te tyre"; dhe*
- ✓ *Ligji Nr. 8934, date 05.09.2002 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", ku percaktohet se eshte e detyrueshme qe aktivitetet qe kane ndikim ne mjedis duhet te pajisen me leje mjedisore,*

eshte pergatitur dokumentacioni i duhur drejtuar institucionit te mjedisit per t'u pajisur me Leje Mjedisore te tipit B.

### ***Te dhena per shoqerine***

Shoqeria "BESA GAZ" Sh.P.K ka ne pronesi implantin e depozitave te gazit te lenget (GLN) te me administrator Z. Islam Kazazi. Implanti ndodhet ne rrethin e Kavajes, dhe pikerisht ne fshatin Ballutaj, Komuna Synej.

Shoqeria "BESA GAZ" sh.p.k me aktivitet te sajin kryesor:

***"Import-Export, perpunim, tregtim me shumice dhe pakice te gazit, naftes e nenprodukteve te tyre".***

### ***Informacion i shkurter nga ana e investitorit mbi projektet qe ka zhvilluar***

Aktiviteti i shoqerise "BESA GAZ" Sh.p.k gjate kesaj periudhe mund te permbledhet si me poshte:

- ✓ *ne aktivitetin e vet perfshihet importi i karburanteve, gazit, e nenprodukteve te naftes*
- ✓ *e ka shtrire aktivitetin e vet ne te gjithe qytetin e Kavajes*
- ✓ *ka nje staf inxhiniero-teknik prej 5 specialistesh*
- ✓ *ka rreth 10 punonjes*
- ✓ *ka ne pronesi te vet nje park teper te kompletuar te mjeteve teknologjike qe perdoren ne fushen e transportit te nenprodukteve te naftes.*

### ***Adresa e shoqerise***

Aktiviteti i saj zhvillohet ne qytetin e Kavajes. Selia e shoqerise eshte po ne qytetin e Kavajes.

## PERSHKRIMI I ELEMENTEVE PERBERES TE IMPIANTIT TE GLN-se

Elementet kryesore te Impiantit te GLN-se, te paraqitur ne menyre skematike ne Planimetirne e objektit jane si me poshte :

1. Porta e hyrjes se autobotave
2. Kabina e rojes
3. Ambjentet e zyrave
4. Rezervuaret per GLN (4 cope), me kapacitet 100 m<sup>3</sup> seicili
5. Stacioni i pompave te GLN-se
6. Pjacale e mbushjes se bombolave: me pultin e mbushjes se bombolave dhe Peshoret
7. Pika e shkarkimit te autoboteve
8. Rezervuar uji per MNZ-ne me kapacitet 60 m<sup>3</sup>
9. Pus per marrjen e ujit
10. Hyrje dytesore

Objekti i Impiantit te Depozitimit te GLN-se mund te konceptohet nga ana funksionale si nje pjese integrale e perbere ga pese seksione :

1. Seksioni i pranimit te GLN-se, i cili perbehet nga mjetet transportuese te GLN-se me anekset perkatese;
2. Seksioni i depozitimit te GLN-se, i cili perbehet nga 4 depozita me volum 100 m<sup>3</sup> seicla dhe anekset perkatese;
3. Seksioni i dergimit te GLN-se ne pjacalen e mbushjes se bombolave, icili perbehet nga nje sistem tubacionesh dhe ventilash;
4. Seksioni i mbushjes se bombolave, i cili perbehet nga pistoletet e mbushjes dhe nga peshoret;
5. Seksioni i magazinimit te bombolave te mbushura.





## TE DHENA PER FUNSIONIMIN E IMPIANTIT TE GLN-se

Impianti i Depozitimit te GLN-se do te funksionoj ne menyre te ngjashme si me nje magazine per ruajtje te GLN-se ne sasira relativisht te medha, dhe njekohesisht te shitjes me shumice (autocisterna ose bombola me GLN). Pra, ne menyre te thjeshtuar kemi te bejme me konceptin "magazinim" per qellime ruajtje dhe "tregtim me shumice".

Pra kemi te bejme me procese ruajtje dhe tregtimi te produkteve te gatshme, pa procese perpunimi. Ne keto kushte te zhvillimit te aktivitetit (**ruajtje dhe tregtim** te GLN-se) procesi eshte krejt konvencional me menyren si funksionojne dhe jane te perbere keto impiante.

Lenda e pare (GLN) sigurohet nga importi me shumice, pasi do te pergatiten kontrata me firmat eksportuese qe bejne shitje me shumice te GLN-se.



GLN-ja transportohet me autobotet e shoqerise per ne Impiantin e Shoqerise, dhe depozitohet ne kater depozitat qendrore stacionare te Impiantit. Ne kete impiant jane te instaluar gjithsej 4 cisterna, me kapacitet depozitues  $100 \text{ m}^3$  seicila.

**Kapaciteti total i depozitave te GLN-se eshte  $400 \text{ m}^3$**

Depozitat jane te pajisura me valvola sigurimi, te cilat ne rast te presionit mbi vleren e lejuar ne te cilen ato jane taruar, hapen dhe shkarkojne gaz ne ajer, per nje moment, deri sa vlera e presionit te arrije ne vleren e taruar. Ne kete menyre realizohet mbrojtja e rezervuareve nga rreziku i shperthimit. Normalisht kohezgjatja e shfryrjes eshte e shkurter. Depozitat e GLN-se jane te pajisura gjithashtu me manometra vizuale per matjen e presionit te gazit ne depozita.

Me valvola sigurie jane te pajisura dhe tubacionet e gazit, te cilat bejne te njejten gje, per te ruajtur tubacionet nga rreziku i shperthimit ne rast te rritjes se presionit mbi vleren e lejuar.

Ne impiant eshe funksional dhe nje sistem ftohes i depozitave me dush uji nga siper, per te realizuar kontrollin e rritjes eventuale te temperatures ne stinen e nxehte, gje qe mund teshkaktoje rritjen e presionit ne depozitat e GLN-se. Ky sistem perdoret periodikisht vetem ne dite teper te nxehta. Uji qe perdoret per ftohje eshte krejtesisht i paster dhe mund te riqarkullohet, ose te derdhet ne kanal in e shkarkimit te ujerave te impiantit, pa shkaktuar ndonje ndotje te ujrave siperfaqesore.

Ne ajer shkarkohen normalisht vetem sasira shume te vogla gazi ne momentet e shkeputjes se bombolave nga pistoleta e mbushjes, sasi kjo qe hollohet menjehere, pasi pjacalet e mbushjes se bombolave jane mjedisore te hapura. Pra nuk ka rrezik per krijimin e perzirejeve ajer-GLN ne vlera eksplozive.

Vlen te theksohet se te gjitha instalimet jane ne mjedis te hapur, gje qe ben te mundur largimin e menjehershem te cdo rrjedhjeje eventuale te gazit. Ne rast te rritjes se presionit te depozitave te GLN-se, apo ne sistemin e tubacioneve, hapen valvolat perkatese te sigurimit, nepermjet te cilave shkarkohet gaz ne atmosfere, deri sa te ulet presioni ne vlerat e lejuara te sigurise se impiantit. Ky gaz shkarkohet ne atmosfere dhehollohet ne ajer duke mos perbere keshtu ndonje rrezik per punonjesit apo ndotje te mjedisit. Duhet theksuar se shkarkime tetilla mund te ndodhin teper rralle, ose asnjehere gjate gjithes jetes se ketyre impianteve te depozitimit te GLN-se.

Mbushja e bombolave me GLN do te behet me anen e pajisjeve bashkekohore, duke siguruar eliminim te plote te rrjedhjeve. Bombolat e mbushura do te gjejne perdorim komunal per djegie (ngrohje ose gatim) ne familje, subjekte private, ne industri apo ne institucione.

Proceset e furnizimit te depozitave me GLN, dhe procesi i shitjes me pakice, jane procese qe kryhen me sisteme te mbyllura, hermetike dhe te kontrolluara rigorozisht. Kjo menyre punimi do te eliminoje ne maksimum humbjet nga rrjedhjet dhe clirimin e avujve ne ajrin e zones perreth.

Po ashtu nga ky aktivitet nuk pritet te kete mbetje teknologjike, pasi kemi te bejme vetem me shitje te tere sasise se GLN-se qe vjen dhe depozitohet ne kete impiant depozitimi dhe mbushje bombolash me GLN.

Gjithashtu nga ky aktivitet nuk ka shkarkime te ujrave te ndotura, pasi ne rast te ndonje avarie (renie zjarri) sasira e ujit te perdorur do te kaloje ne kanal in grumbullues dhe ne gropen e seperimit.

Skema e funksionimit te Impiantit mund te permbledhet ne menyre te thjeshtuar si me poshte:

- GLN-ja (butan-propan) sillet e autobot nga importi me rruge detare ose tokesore;
- Depozitohet ne rezervuaret e instaluar ne impiant;
- Me anen e pompave centrifugale dhe te nje sistemi tubacionesh e ventilash perkatese tip pistolete, nepermjet tubash gome, futet me presion ne bombola metalike te cilat peshohen dhe magazinohen per tregtim me shumice.

## KAPACITETI I DEPOZITIMIT TE IMPIANTIT TE GLN-se

Kapacitetet depozituese se Impiantit te Depozitimit dhe Mbushjes se Bombolave me GLN do te jene 4 rezervuare mbitokesore per depozitim te GLN-se. Sejcili prej tyre do te kete kapacitet prej 100 m<sup>3</sup>.

Paretet e ketyre rezervuareve jane te trashesise:

Ballore > 6 mm

Anesore > 6 mm

GLN-ja transportohet me autobotet e shoqerise per ne Impiantin e Shoqerise, dhe depozitohet ne kater depozitat qendrore stacionare te Impiantit. Ne kete impiant jane te instaluara gjithsej 4 cisterna, me kapacitet depozitues 100 m<sup>3</sup> seicila.

**Kapaciteti total i depozitave te GLN-se eshte 400 m<sup>3</sup>**

Furnizimi i automjeteve dhe i bombolave me GLN do te behet me anen e pajisjeve bashkekohore, duke siguruar eliminim te plote te rrjedhjeve.

Depozitat e GLN-se do te furnizojne, nepermjet linjave teknologjike nentokesore, 2 distributore me 2 pistoleta aktive. Depozitat jane instaluar ne pjesen fundore te Impiantit, dhe jane te vendosur ne jasteke betoni ne lartesi mbi 1.5 metra nga siperfaqja e tokes. Lidhjet teknologjike jane te vendosura ne lartesi te pakten 1 meter nga siperfaqja e tokes.

## VENDNDODHJA E IMPIANTIT TE GLN-se

Objekti ndodhet ne dalje te qytetit te Kavajes, pergjate rruges nacionale Kavaje-Rrogozhine, ne krahun e djathte dhe rreth 500 m larg saj, ne nje parcele ne afersi te fshatit Ballutaj, Komuna Synej, territor ky nen juridiksionin e Rrethit Kavaje.

Siperfaqja totale e truallit ku eshte ndertuar Stacioni i depozitimit te GLN-se, se bashku me infrastrukturen ndihmese dhe funksionale eshte 2 000 m<sup>2</sup>.


### ***Impianti i GLN-se ndodhet ne parcelen me keto te dhena:***

- |   |                  |        |
|---|------------------|--------|
| - | Zona Kadastrale  | 8552   |
| - | Numri i Pasurise | 12/151 |
| - | Fshati Ballutaj  |        |
| - | Komuna Synej     |        |

### ***Kufizimet e pasurise jane:***

- |   |                      |                           |
|---|----------------------|---------------------------|
| - | <i>nga Veriu</i>     | <i>me pasurine 12/150</i> |
| - | <i>nga Lindja</i>    | <i>me pasurine 18/1</i>   |
| - | <i>nga Jugu</i>      | <i>me pasurine 12/152</i> |
| - | <i>nga Perendimi</i> | <i>me pasurine 12/150</i> |





*Vendndodhja e Implantit te depozitimit dhe mbushje bombulash me GLN*

### **Objektivat dhe Qellimi i VNM-se**

Objektivat e VNM-se konsistojne ne analizimin e faktoreve pozitive e negative mjedisore, ne propozimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative, si dhe ne permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit gjate ndertimit dhe shfrytezimit te implantit te depozitimit te gazit te lenget.

**Qellimi i VNM** eshte qe nepermjet vleresimit cilesor e sasior paraprak te parametrave teknologjike te aktivitetit qe do te zhvillohet, te bazuara ne kriteret e standarte shkencore nderkombetare, te tipizohen dhe te perzgjidhen nje sere parametrash dhe vecorish te sistemeve te siperpermendur natyrore, ne sherbim te infrastruktures mjedisore, te infrastruktures urbane, si dhe ndertimit dhe shfrytezimit te *implantit te depozitimit te gazit te lenget*.

### Raporti i VNM-se ka per qellim te sherbeje si instrument:

- ❑ per mbrotjen e mjedisit;
- ❑ ne informimin e komunitetit per veprime ne mbrojtje te mjedisit;
- ❑ ne kontrollin e perdorimit te qendrushem te burimeve natyrore;
- ❑ ne rritjen e mireqenies dhe forcimit te ekonomise se zones dhe te vendit;
- ❑ ne mbrojtje te pasojave financiare dhe socio-ekonomike;
- ❑ ne rritjen e interesimit per bashkepunim dhe ne gjetjen e zgjidhjeve te reja, etj.

### EFEKTET POZITIVE DHE NEGATIVE TE IMPIANTIT TE GLN-se NGA PIKPAMJA E NDIKIMEVE NE MJEDIS

Ndertimi dhe funksionimi i Impiantit te Depozitimit te GLN-se dhe me tej per shitje me shumice per te trete (hotele, lokale, dyqane shitjesh, etj) do te kete ne menyre te natyrshme ndikimet e tij ne mjedisin e zones ne fjale, dmth. ne territorin qe kufizon Impiantin, por edhe ambientet publike kufitare deri ne nje distance te caktuar. Ne te njejten kohe do te kete ndikim ne banoret e komunitetit, ne zonen perkatese, etj.

Impianti i administruar nga Shoqeria "BESA GAZ" me DrejtorE te Pergjithshem Z. Islam Kazazi, me stafin punonjes do te kryeje aktivitetin kryesor:

- ◆ depozitim me shumice te GLN-se,
- ◆ shitjen me shumice (me autocisterna) dhe me pakice (me bombola).

Ne menyre te vazhdueshme, nga pikpamja e kembimit te efekteve e vlerave me mjedisin rrethues, ky aktivitet do te konsiderohet nje proces i vijueshem pune i stafit te impiantit per ruajtjen dhe permiresimin e vlerave mjedisore ne territorin e impiantit e zonen perreth tij, per minimizimin e efekteve negative dhe shtimin e atyre pozitive.

### **EFEKTET POZITIVE**

- Territori ku eshte ndertuar objekti eshte marre me qera nga shoqeria "BESA GAZ". Aktualisht trualli eshte i perbere nga hapesire boshe, ne distance rreth 500 m larg rruges nacionale Kavaje-Rrogozhine. Me realizimin e ketij projekti subjekti e ka ndryshuar kete mjedis ne favor te nje Impianti per Depozitim dhe Mbushje te Bombolave me GLN bashkekohor e modern, c'ka perben nje permiresim te dukshem nga ana vizuale.
- Vendi i zgjedhur per ndertimin e Impiantit te GLN-se eshte mjaft i favorshem. Impianti i GLN-se se bashku me infrastrukturen e tij funksionale eshte i vendosur ne nje zone larg banesave dhe aktiviteteve te tjera ekonomike duke shmangur e minimizuar mundesine e ndodhjes se aksidenteve.
- Vendi i zgjedhur per ndertimin e Impiantit te GLN-se eshte i favorshem edhe per faktin se ploteson kushtet teknike e urbanistike. Rreth e rrotull tij, prapa, ne te majte e ne te djathte te objektit gjenden siperfaqe te lira dhe nuk zhvillohen aktivite apo te jete ne ndertim ndonje objekt tjetere. Objekti me te gjitha infrastrukturen polifunksionale te planifikuar, eshte i hedhur ne gen-plan (shih plan vendosjen).

- Nje epersi te dukshme ne ndertimin e Impiantit te GLN-se ne pozicionin ne fjale perben fakti, se ai gjendet ne distanca te pranueshme largesie karshi zonave te banimit, duke menjanuar keshtu ne nje mase te konsiderueshme ndotjet dhe zhurmat per komunitetin. Nga keto fakte kemi aresye te besojme se aktiviteti i Impiantit te GLN-se, i shoqeruar normalisht edhe me masa te tjera teknike preventive, nuk do te shkaktoje reagime e ankesa te cfaredo lloji nga ky komunitet.
- Nje Impiant i tille bashkekohor me infrastrukture funksionale do te zgjidhe me se miri punesimin e te pakten 10 punonjesve te rinj, punetore sherbimi ne mbushje dhe shperndarje, duke perfshire ketu specialiste hidrokarburesh, mekanike, ekonomiste etj, fakt qe perben nje efekt pozitiv nga pikpamja social-ekonomike.
- Ne pjeset kufitare te territorit te impiantit te GLN-se dhe ne vecanti ne pjeset anesore te tij, jane krijuar siperfaqe te mbjella me gjelberim me drure dekorative e lule natyrale. Efekti i tyre pozitiv natyrshem do te kompensoje efektet mjedisore te specifikes se aktivitetit, por dhe nga pamja vizuale, siperfaqet e gjelberuara dhe mikroterritoret shlodhese ne to, do te japin nje tablo urbane te kenaqeshme.

### **EFEKTET NEGATIVE**

Ne pergjithesi per shkak te specifikes se aktivitetit, Impianti qe kerkohet te vihet ne funksionim do te paraqese mundesine e lindjes dhe veprimit te efekteve negative me rezultat ndotjen mjedisore ne territor, por dhe ne ambientin perreth tij deri ne nje distance te caktuar.

#### **Ndotje te mjedisit mund te vijne nga:**

- *Rrjedhja e karburanteve apo lubrifikanteve gjate furnizimit te automjeteve.*
- *Shperndarja e gazrave ne hapsiren qe kufizon territorin, por dhe perreth tij, gjate manipulimeve te ndryshme qe kryhen ne Impiant.*

#### **Ndotjet mund te jene:**

- *ujrat dhe lengjet qe precipitojne nga zonat e furnizimit me GLN,*
- *ujrat larese qe precipitojne nga zonat e parkimit te automjeteve,*
- *ujrat larese qe kane origjine larjet e territorit te Impiantit te GLN-se, e ne vecanti pjeses se distributoreve, te zyres se sherbimit, WC-se, etj.*

#### **Ndikimi nga depozitimi ne ujrat nentokesore i materialeve dhe mbeturinave qe ndotin ujin mund te jene:**

- *vajrat minerale dhe kimikatet (aditivet) ne sherbim te tyre,*
- *mbetjet e vajrave te perdorur,*
- *detergjentet e ndryshme qe perdoren ne pune e siper,*

- mikrombetje te ndryshme me origjine mekanike,
- mbeturina te ndryshme nga larjet, etj.

**Ndikimi nga zhurmat me origjine te ndryshme mund ose do te jene:**

- nga trafiku i mjeteve te furnizimit,
- nga moto-gjeneratori, etj.

**Ndikimi ne ndotjen e ajrit mund ose do te jete:**

- nga avullimi i karburanteve dhe vajrave,
- nga rritja e perqendrimet per shkak te pluhurave e tymrave te aktivitetit.

**Ndikimi per raste aksidentale e rreziqe te tjera:**

- zjarret mund te jene prezent,
- avari te ndryshme mund ose do te jene prezente, etj.

**Ndikimi ne rritjen e kerkesave per perballimin e problemeve te mesiperme nepermjet:**

- Shtrimet e sistemimit te territorit.
- Sigurimit teknik dhe instruktimi per MNZ i punonjesve e specialisteve qe do te punojne ne Impianti e GLN-se, duhet te jete ne nivelet e kerkuare sipas rregullores perkatese ne fuqi.
- Furnizimi me energji elektrike te jete i vazhdueshem.
- Automjete furnizuese (autobotet) do te jene te siguruara ne fillim te shkarkimit e deri ne fund.
- Furnizimi me uje te pijshem dhe me ate qe do te perdoret gjate punes.
- Problemi i zgjidhjes se kanalizimeve dhe seperatorit te ujrave te ndotura aksidentalisht.

**MASAT E MARRA PER MINIMIZIMIN E PASOJAVE QE MUND TE KENE NE MJEDIS EFEKTET E MESIPERME NEGATIVE DHE RITJEN E ATYRE POZITIVE**

Bazuar ne qellimet kryesore e ne veçanti ate final, minimizimin ne maksimum te efekteve negative te lartpermendure dhe rritjen e atyre pozitive ne mjedis, stafi i Impiantit te GLN-se i administruar nga Z. Islam Kazazi, do te kryeje aktivitetin ne Impiant duke marre e vene ne zbatim masat konkrete si me poshte:



- **Per ndotjen e mjedisit nga gazi i lenget qe mund te rrjedhe gjate furnizimit te depozitave me autobot ose gjate mbushjes se bombolave ne pistoletat e mbushjes**

6. Kanali i grumbullimit te ujrave dhe karburanteve qe eventualisht mund te derdhen gjate manipulimit te tyre, do te perfundojne ne separatorin e ndarjes se hidrokarbureve nga uji.
7. Çisterna e depozitimit te hidrokarbureve mbetje do te grumbulloje mbetjet e ndotjet gjate aktivitetit, dhe mbas nje cikli kohor do te mblidhen keto te fundit per t'u dorezuar per djegje apo riciklim sipas procedures se udhezuar nga ARM-ja Kavaje.
8. Rezervuaret (depozitat metalike) do te jene me spesor mbi 6 mm, te tipit cilindrike horizontale, te lyer me boje anti korodive dhe dy duar shtrese bituminoze. Bokaportet, linjat e furnizimit te dyfishte si dhe tubat e ajrimin do te jene te montuar ne rezervuare konforme kerkesave tekniko teknologjike te eneve nen presion. Ato do te vendosen ne siperfaqe me mbeshtetese betoni. Mbas montimit te tyre dhe lidhjes se linjave te furnizimit me distributoret, ato do te provohen per ndonje carje te mundeshme me zbatimin e nje presioni hidraulik prej minimumi 0,75 kg/cm<sup>2</sup>.
9. Furnizimi i rezervuareve me GLN do te behet me autobote, parametrat teknike e teknologjike te te cileve do te jene ne perputhje me kerkesat e eneve nen presion. Mbushja e autoboteve apo bombolave me GLN prej tyre do te behet nepermjet tubacioneve metalike qe sigurojne nje rrjedhje me presion konstant per ne impiantin e mbushjes, i pajisur me sistemin manometrik per te kontrolluar presionet e punes. Muftat bashkuese ne te dy ekstremet e tubacionit do te jene objekt i rendesishem kontrolli per riparim apo zevendesim te mundeshem ne rast demtimi.
10. Furnizimi me GLN do te behet ne distributore universal nepermjet pistoletave. Distributoret do te jene te vendosur ne bazament betoni duke respektuar rigorozisht balancimin, distancat e lirshmerite ne manipulimet e ndryshme ne to e perreth tyre. Gjate sherbimit, kolaudimit apo ndonje riparimi te mundeshem te pjeseve te distributoreve (pompa, tuba fleksibel, pistolete, etj), do te merren masa qe pajisjet te jene jashte sistemit te funksionimit te impiantit.

- **Per ujrat e ndotura dhe me mbetje**

5. Ujrat e ndotura dhe me mbetje qe do te precipitohen ne zonat e furnizimit, do te grumbullohen e do te trajtohen me separator te standartizuar, duke ndare mbetjet hidrokarbure e derivatet e tyre vajore.
6. Ujrat e godinave, zyrave dhe sheshit te impiantit te GLN-se qe mund te precipitohen nga rreshjet apo larjet ne sheshin para tyre, do te kullojne ne kanalet anesore nga ku te grumbulluara, do te vazhdojne te shkarkohen ne pusetat anesore te impiantit, e me tej ne kanalin kryesor, qe kalon aty prane rruges nacionale.
7. Ujrat qe do te precipitohen nga mjedisi rrethues gjate rreshjeve, do te kullojne e grumbullohen ne kanalet anesore e me tej ne kanalin kryesor te zones.
8. Ujrat e zeza te WC-se, banjos etj. do te shkarkohen direkt ne rrjetin e kanalizimeve ne magjistralin kryesor te ujrave te zeza qe perfundon ne nje grope septike.

- **Per mbrojtjen e ujrave nentokesore**

4. Rezervuaret (kapacitetet depozitues) do te jene cilesisht te garantuara si dhe te provuara paraprakisht nen presion mbi ate te lejuarin. Po kete garanci do te kene sistemi i tubacioneve furnizues te pompave te distributoreve dhe tubat e ajrimit. Siperfaqet e tyre ne kontakt me token do te jene te perpunuara me boje e lende hidroizoluese. Rezervuaret do te mbeshteten ne jasteke betoni. Ne ndihme te zbulimit te shpejte te rasteve aksidentale te tille, do te sherbeje vendosja ne depozitat e nje sinjalizuesi

automatik. Po keshtu edhe linjat teknologjike do te jene te pajisura me aparature paralajmeruese ne raste rrjedhjeje.

5. Ne ndihme te vazhdimet te aktivitetit per raste aksidenti eshte parashikuar vendosja e nje rezervuari rezerve.
6. Pistoletat e mbushjes me GLN do te jene bashkekohore dhe cilesisht te garantuara. Pjeset e tyre do t'ju nenshtrohen periodikisht kontrollit vizual e teknik, kryesisht per ndonje carje te mundeshme per te cilat do te kete sinjalizues automatik. Lidhjet teknologjike me rezervuaret do te garantohen nga sisteme tubash metalike te cilesise se larte. Teresia e bazamentit te betonit dhe vendosjes se distributoreve ne te do te jete konform parametrave rigorozisht te percaktuar. Paralelisht me distributoret do te ndertohet nje kanal i vogel per te garantuar grumbullimin e rrjedhjeve ne ndonje rast te mundeshem, e qe me tej do t'i drejtoje ato ne nje mini-depozite te posacme per te tilla raste.

- ***Per asgjesimin e mbetjeve***

3. Mbetjet jo te rrezikshme do te veçohen nga komponentet e pasterta e do te grumbullohen per nje depozitim e riciklim te mundeshem.
4. Mbetjet e rrezikshme ne te cilat do te bejne pjese ato vajore, vajra rrjedhese, agjente te ndryshem kimike, bojra, detergjente, etj. do te depozitohen ne nje kolektor te caktuar per grumbullimin e ketyre lloj mbetjeve.

- ***Per minimizimin dhe evitimin e zhurmave te mundeshme***

3. Vend-ndodhja e impiantit te GLN-se, eshte planifikuar te jete ne nje distance te mjaftueshme nga vendbanimet e sektoret sociale te komunitetit te zones, distance kjo qe minimizon efektin zhurme e nuk do te sjelle probleme e gjeneroje reaksion negativ te tyre.

- ***Per eliminimin e ndotjeve te ajrit***

2. Per ruajtjen e nje temperature konstante sidomos gjate stines se veres, si kusht i domosdoshem paraprak per minimizimin e ngritjes se temperatures ne depozitat e GLN-se, pjesa e siperme e depozitave mbitokesore deri ne bokaportin e furnizimit, do te jete e mbuluar me nje sistem dushi me uje qarkullues nga depozita e ujit te impiantit.

- ***Per menjanimin e korrozionit dhe carjes se depozitave***

1. Per menjanimin e gerryerjeve, carjeve nga korrodimi te depozitave, do te merren te gjitha masat paraprake dhe ato kontrolluese gjate funksionimit qe kemi permendur me siper.

- ***Per zgjidhjen e problemit te mbetjeve te ngurta***

1. Ne rast pune normale te impiantit te GLN-se nuk do te krijohen mbetje te ngurta. Vetem gjate pastrimit periodik te rezervuarit, proces ky qe kryhet normalisht nje here ne pese vjet, do te merren masa qe parashikojne nje rast te tille ose me vendosjen e nje vaske portative ose me ndertimin e nje vaske betoni 2m X 1m X 1m per grumbullimin e mbetjeve nga rezervuaret.

- ***Per zgjidhjen e problemit te furnizimit me energji elektrike***

1. Te gjitha pajisjet e mjetet si depozitat, linjat teknologjike, pompat, etj. ku ruhet, perpunohet e qarkullon GLN-ja, per te eliminuar rreziqet e krijimit ne to te ngarkesave elektrostatische, do te jene te tokezuara.

4. Per gjithë sistemin e linjave qarkulluese nuk do te kete saracineska nderperrese por bashkim me fillanxha, qe te jete e siguruar lidhja elektrike e vazhdueshme me ane te urave.

- **Per sigurimin e autobotit**

2. Autoboti do te jete i pajisur me zinxhirin e sigurise (shkarkimit) ndaj ngarkesave elektrostatische dhe ne te njejten kohe, para fillimit te zbrazjes (rimbushjes), do te tokezohe nepermjet ures lidhese tek pika e tokezimit (nyja) (shih gen-planin e objektit, rrjeti elektrik 0,4 Kv dhe tokezimi).

- **Per eliminimin e rasteve aksidentale si zjarre, shkarkime atmosferike, elektrike, etj.**

Ndertimi i impiantit te GLN-se ka patur parasysh dhe ka realizuar kerkesat teknike te vena nga Sektori i MNZ-se si me poshte:

- o Te vendosen rezervuaret mbi jasteke betoni.
- o Sistemi i pompave te vendoset 30 m larg rezervuareve te GLN-se.
- o Te ndertohet argjinature me bazament mur beton.
- o Mbi cdo rezervuar te vendoset sistem i ftohjes me uje.
- o Te ndertohet sistemi i shkarkimeve atmosferike.
- o Te ndertohet sistemi i kanalizimeve per dekantim dhe avakuim.

Duke respektuar dhe realizuar detyrat e lena nga MNZ-ja, mund te permendim se:

6. Per menjanimin e rasteve aksidentale si zjarre, shkarkimet, etj. do te jene ne gadishmeri ne vendin e caktuar 5 fiksa universal me kapacitet 10 litra seicili (3 ne depozitat dhe 2 ne aparatit distributor), dhe nje fikse e levizeshme 35 literse me rrota. Pajisjet shuarese do te jene te kater shkalleve te shuarjes se zjarrit.
7. Ne impiantin e GLN-se eshte parashikuar te vendoset nje depozite uji me kapacitet 60 m<sup>3</sup> uje.
8. Ne pika te ndryshme te impiantit te GLN-se do te jene te vendosura tabela kundra zjarrit.
9. Do te jene te afishuara rregulloret per mbrojtjen nga zjarri dhe ato te sigurimit ne pune.
10. Do te jete ne gjendje gadishmerie nje shkarkues elektrik

Duke qene se projekti ne te gjitha elementet e tij eshte i realizuar nga specialiste te fushave perkatese e do te zbatohet konform orientimeve te tyre, mendohet te mos kete asnje premise per rast aksidental. Eshte pikerisht pergjegjesia e larte me te cilen do te zbatohet ky projekt kushti themelor i garancise se banoreve te zonave perreth impiantit per mos pasje rasti te tille.

- **Per shtrimin dhe sistemimin e territorit**

3. I gjithë territori qe perfshin impiantin e GLN-se do te jete i shtruar e i sistemuar konform projektit ne parametra e standarte bashkekohore
4. Siperfaqe te gjelberuara do te jene ne pjese te ndryshme konform projektit dhe ne vecanti ne brezin qe do te kufizojë impiantin ne pjeset anesore.

- **Per sigurimin teknik te punonjesve**

2. Ne dokumentacionin bashkelidhur projektit, do te jene paraqitur rregullat e sigurimit ne pune, instruktazhi i vecante per kushtet e punes me lende djegese dhe masat e mbrojtjes nga zjarri, etj.

## MASAT REHABILITUESE, NE RAST NDOTJEJE DHE DEMENTIMI TE MJEDISIT

Masat per mbrojtjen e mjedisit, qe jane marre nga ana e shoqerise jane:

- rregullimi, sistemimi dhe rrethimi i territorit,
- instalimi i sistemit te seperimit te ujrave te grumbulluara nga kanalet siperfaqesore te objektit,
- jane bere kanalizimet e brendshme te objektit te lidhura me tubacionin kryesor qe shkarkohet ne kanalin prane objektit,
- sistemet e parandalimit te aksidenteve ne impiant:
  - sinjalizuesit e rrjedhjeve te mundeshme te GLN-se
  - sistemi i ftohjes se depozitave ne stinen e nxehte
  - sistemi ifikes se zjarrit aksidenta, etj.

## PROBLEMET SOCIALE

**Punesimi.** Sektori i shitjes se karburanteve dhe nenprodukteve te saj me shumice dhe pakice zen nje vend te vogel ne perqindjen e aktiviteteve te biznesit, ku pjesen me te madhe e zene sherbimet. Por megjithate duke marre parasysh kerkesen ne rritje per to, keto aktivitete jane per t'u marre ne konsiderate dhe ne numrin e te punesuarve. Per kete zone krijimi i 10 vendeve te reja pune paraqet nje mundesi per angazhim te banoreve te zones perreth.

Gjate periudhes qe impianti i GLN-se do te vihet ne funksionim nuk ka per te rezultuar asnje problem social, si dhe nuk do te perbeje asnje shqetesim per banoret e zones perreth. Ndonese ka nje numer te kufizuar punonjesish, eshte patur parasysh nga ana e administratorit te shoqerise qe te punesohen banore te kesaj zone.

Sic eshte parashtruar edhe ne Gen-Planin qe ndodhet se bashku me dokumentacionin e shoqerise objektet e banimit jane ne largesi me objektin ku zhvillohet aktiviteti.

**Bujqesia.** Ne nje kendveshtrim tjeter, Kavaja eshte nje rajon qe vite me pare eshte njohur si bujqesor, ndersa pas ndryshimeve te viteve te fundit, bujqesia nuk perben me bazen me te rendesishme ekonomike. Kjo vjen per shkak te shndrrimit te karakterit te zones ne teresi nga bujqesor ne urban. Nder aresyet e renies se sektorit bujqesor eshte dhe fakti qe njerezit nuk shfaqin interes per t'u marre me bujqesi, dhe ata po punesohen gjithnje e me teper ne sektore te tjere te tille, si industria dhe sherbimet.

## SIPERFAQJA PYJORE

Zona e zgjedhur per ndertimin e impiantit te GLN-se eshte miratuar aktualisht si zone per aktivitetet ekonomike jo ndotese. Pra eshte shesh i lire per ndertime objektesh ekonomike.

## FLORA, FAUNA, EKOSISTEMET

Vlerat faunistike ekzistuese dhe potenciale te zones nuk jane shume te pasura. Flora perbehet nga shume elemente te flores mesdhetare.

## TE DHENAT MBI KLIMEN

Klima e zones se Kavajes eshte klime tipike mesdhetare, qe karakterizohet me dimer te bute, ne raste te rralla me ngrica apo me rreshje debore.

Stina e veres karakterizohet me periudha te gjata te nxehti dhe thatesire, ndersa stina e vjeshtes sidomos muajt Nentor-Dhjetor ka sasine me te madhe te rreshjeve te shiut.

**Temperaturat.** Muajt Janar dhe Shkurt jane pergjithesisht muajt me te ftohte te vitit, gjate te cileve temperaturat minimale zbresin edhe nen zero grade, por temperatura mesatare e ketyre muajve luhetet midis 10-14 grade Celsius.

Muajt me te nxehte te vitit jane muaji Korrik dhe Gusht me nje temperature mesatare prej 22-26°C. Ne periudha te vecanta gjate ketyre 2 muajve temperaturat arrijne edhe 33-38 grade Celsius.

**Ererat.** Nga studimet shumevjecare te kryera rezulton se ne kete zone drejtimi i ererave eshte lindje-perendim dhe anasjelltas. Ererat qe fryjne ne kete zone, sidomos gjate stines se veres favorizohen edhe nga prania e detit qe ndodhet prane zones se qytetit Kavaje. Shpejtesia mesatare e eres eshte afersisht ne vlerat 1,6-1,8 m/sek.

**Reshjet.** Sasia mesatare vjetore e rreshjeve arrin 1.100-1400 mm. Muajt me me shume rreshje jane muajt Nentor, Dhjetor dhe Janar, ndersa sasia me e vogel e rreshjeve bie gjate muajve Korrik, Gusht, Shtator.

Zona e Kavajes karakterizohet pergjithesisht me vleren mesatare vjetore te rreshjeve te shiut te vendit.

**Diellzimi.** Ne zonen e Kavajes dhe perreth ditet me diell zene afersisht 280 dite/vit.

## HIDROGJELOGJIA E VENDBURIMIT

Vendi qe propozohet nuk ka probleme hidrogjeologjike. Nga studimet hidrogjeologjike vihet re se ne vendin ku eshte ndertuar ipianti i GLN-se nuk ka rezerva uji nentokesor.

## **P E R F U N D I M E:**

Duke pare projektin ne kompleksitetin e vet si nje Impiant Depozitimi dhe Mbushje te Bombolave me GLN per shitje me shumice dhe pakice te saj, mendojme se duke zbatuar me rigorozitet parametrat bashkekohore te zhvillimit te ketij lloji aktiviteti, duke e manaxhuar me kujdes e ne menyre te vazhdueshme ate, por dhe masat e siperpermendura per ruajtjen e permiresimin e mjedisit, pasojat negative qe shoqerojne natyrshem kete aktivitet do te jene te kontrolluara.

**Pergatiti VNM- ne:**

**Inxh.Mj.Raimina Hakrama**  
**Ekspert i VNM-se dhe Auditimit Mjedisor**

Ripaisje per leje mjedisore  
Objekti: "Impiant depozitimi dhe mbushje bombulash me GLN"

---

**Fatura e pageses se tarifes she sherbimit per lejen mjedisore te tipit B**